



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.165/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E. M., A. M.1, A. M.2, A. M.3, të gjithë nga fshati ..., të cilët i përfaqëson me autorizim avokat Naser Morina nga L..., dhe F. D. e vajzërisë M. nga fshati ..., të cilën e përfaqëson avokat Labinot Buzuku nga P. , kundër të paditurës Komuna e Lipjanit të cilën e përfaqëson sipas autorizimit F. M., me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.1952/2020, datë 16.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.07.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditësve, avokat Labinot Buzuku nga P.a, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë, Ac.nr.851/2017, datë 16.06.2021.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.526/2018 të datës 12.02.2020 në pikën I. aprovohet kërkesëpadia e paditësve E. M., A. M.1, A. M.2, A. M.3, dhe F. D., e vajzërisë M., që të gjithë nga fshati ..., si e bazuar, dhe vërtetohet se paditësit e kanë fituar pronësinë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në palujtshmërinë në përbërje prej ngastrës kadastrale P-..., në vendin e quajtur "... " në sipërfaqe prej 944m2, ngastrës kad.nr. P-... në vendin e quajtur "Shkark gornje pashnjak" në sipërfaqe prej 5209m2, ngastra kadastrale nr. P-... në vendin e quajtur "Shark

Gornja livada”, në sipërfaqe prej 8115m², ngastra kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Njive Ispod puta" në sipërfaqe prej 26127m², ngastra kad.nr P-..., në vendin e quajtur "Njive Ispod Puta" në sipërfaqe prej 320m², ngastra kad.nr. P-..., në vendin e quajtur "Njive Ispot puta" në sipërfaqe prej 1313m², ngastra kad. nr.P-..., në vendin e quajtur "Njive ispod shлива" në sipërfaqe prej 23960m², ngastra kad.nr. P-..., në vendin e quajtur "Sello Shark" në sipërfaqe prej 6816m², ngastrës kadastrale P-..., në vendin e quajtur "Shark" në sipërfaqe prej 12038m², dhe ngastrës kadastrale nr.P-71409087-00339-0 në vendin e quajtur "Shark Zajednike" në sipërfaqe prej 2731m², të gjitha këto ngastra kadastrale në ZK ..., dhe obligohet e paditura Komuna e Lipjanit, që paditësve tua njoh të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri dhe të duroj që paditësit në këto paluajtshmëri të regjistrohen si bashkëpronar në librat publik të paluajtshmërive, në të kundërtën ky aktgjykim paraqet titull juridik për regjistrimin e këtyre paluajtshmërive në bashkëpronsi të paditësve në librat publik të paluajtshmërive.

II. Secila palë ndërgjygjësore i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1952/2020, datë 16.01.2022, në pikën I aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.526/2018, i datës 12.02.2020 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: refuzohet si tërësisht e pabazuar kërkesëpadia e paditësve E. M., A. M.1, A. M.2, A. M.3 dhe F. M. D., të gjithë nga fshati ..., Komuna e L., me të cilën kanë kërkuar që: "të vërtetohet se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në paluajtshmërinë në përbërje prej ngastrës kadastrale P-..., në vendin e quajtur "Sello u dvorishte", në sipërfaqe prej 944m², ngastrës kadastrale nr.P-..., në vendin e quajtur "Shkark gornje pashnjak", në sipërfaqe prej 5209 m², ngastra kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Shark gornja livada", në sipërfaqe prej 8115 m², ngastra kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Njiva Ispod puta", në sipërfaqe prej 320m², ngastrën kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur " Njiva Ispot puta" në sipërfaqe prej 1313 m², ngastra kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Njiva ispod shлива" në sipërfaqe prej 23960 m², ngastrën kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Sello Shark" në sipërfaqe prej 6816 m², ngastrën kadastrale nr.P-...në vendin e quajtur "Shark" në sipërfaqe prej 12038 m, dhe ngastrën kadastrale nr. P-..., në vendin e quajtur "Shark Zajednik" në sipërfaqe prej 2731m², gjitha këto parcela në Z.K ..., dhe obligohet e paditura Komuna e L..., që paditësve të ju njohë të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri dhe të duroj që paditësit në këto paluajtshmëri të regjistrohen si bashkëpronarë në librat publik të paluajtshmërive, në të kundërtën ky aktgjykim paraqet titulli juridik për regjistrimin e këtyre paluajtshërive në bashkëpronsi të paditësve, në librat publike të paluajtshmërive". Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe që të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

E paditura nuk është përgjigjur në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, revizionit dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se :

Revizioni i të autorizuarit të paditësit, avokat Labinot Buzuku nga Prishtina , është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit E. M., A. M.1, A. M.2, A. M.3, dhe F. M. D., të gjithë nga fshati ..., Komuna e L..., me datë 22.04.2010, kanë paraqitur padi në Gjykatën e shkallës së parë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë në bazë të posedimit të pandërprere mbi 20 vite prej kur i kanë në posedim paluajtshmëritë e lartcekura, të cilat janë blerë nga paraardhësit e tyre e fondet për të cilat janë siguruar nga Fondet Ndërkombëtare për strehim të refugjatëve me seli në Gjenevë, që nga viti 1969 e deri me tani janë në posedim të pandërprerë, të ngastrave të përshkruara më detalisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan fillimisht duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.98/2010, të datës 29.01.2014, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve. Gjykata e Apleit me aktvendimin Ac.nr. 1130/2014, të datës 04.12.2018, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës Komuna e Lipjanit, ashtu që ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.98/2010, të datës 29.01.2014, dhe lënda është kthyer në rigjykim në shkallën e parë. Në rigjykim Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.526/2018, të datës 12.02.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, (me gjerësisht si në aktgjykimin e atakuar).

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paraardhësi i paditësve (A. M. - tani i ndjerë) në vitin 1967 nga represioni i shtetit socialist në Shqipëri, si refugjatë politikë ka ardhur në Kosovë, dhe nga mjetet e dhëna nga Fondi Ndërkombëtarë për Refugjatë Politik me seli në Gjenevë, nga Komuna e L., është blerë toka nga pronarët e parcelave në fshatin ..., tokë kjo e cila është regjistruar në emër të

Komunës së Lipjanit dhe paraardhësit të paditësve, e cila me pas i është dhënë me kontratë paluajtshmëria. Me dispozitën e nenit 20 para 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimeve juridike dhe me trashëgimi, dhe në bazë të nenit 28 para 4 i po të njëjtit ligj parashihet se mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin personi tjetër ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vitesh, mbi këtë bazë juridike paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëri mbi bazën e parashkrimit fitues, ngase paraardhësi i paditësve, përkatësisht bashkëshorti i paditëses E., ka hyrë në posedim të paluajtshmërisë kontestuese me mirëbesim dhe në mënyrë ligjore. Gjykata vendosi që secila palë t' i bartë shpenzimet e veta.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, por gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, dhe pas arsyetimit të dhënë për pretendimet ankimore e aprovoi si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjendja faktike nuk është vërtetuar siç duhet, si rezultat i së cilës edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht, duke qenë se paditësit i shfrytëzojnë pronat kontestuese që nga viti 1969, vit kur paraardhësit të paditësve, këtu e paditura me kontratë i kishte dhënë në shfrytëzim këto ngastra për periudhë të caktuar 10 vjeçare, përkatësisht deri në vitin 1978. E si rrjedhojë e këtyre fakteve të prezantuara nga paditësit, sipas tyre, duhet të konstatohet se e kanë fituar pronësinë sipas nenit 28 parag.4 të LMTHPJ-së. Në fakt, sipas parag. 4 të këtij neni, për t'u fituar e drejta e pronësisë, duhet që sendi të mbahet në posedim të pandërprerë dhe të ligjshëm (me mirëbesim), për 20 vite. Në rastin konkret, referuar provave të cekura më lartë dhe gjendjes faktike e cila rezulton nga këto prova, Gjykata e Apelit vlerëson se e

drejta e pronësisë nuk mund t'u njihet paditësve bazuar në provat e dhëna nga ta, duke qenë se është e qartë që nuk janë përmbushur kushtet për fitimin e një pronësie të tillë, sipas nenit 28 të LMTHPJ-së. Dispozita e tillë, kërkon që mbajtësi i paluajtshmërisë për 20 vite, duhet të jetë me mirëbesim, e në rastin konkret, nuk ka asgjë që e vërteton një gjendje të tillë. Përkundrazi, ashtu siç është vërtetuar nga ekspertizat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, por edhe provat materiale tjera siç janë kontratat për dhënien në shfrytëzim të ngastrave kontestuese për periudhën 10 vjeçare, rezulton se paditësit që nga fillimi kanë qenë në dijeni se këto ngastra kanë qenë dhe janë në pronësi të paditurës Komuna e Lipjanit.

Përveç të cekurave më lartë, sipas Gjykatës së Apelit, mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo meqë kemi të bëjmë me pronë shoqërore, pronë kjo specifike që gëzon një mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Në mungesë të një vërtetimi të tillë të ekzistimit të mirëbesimit në shfrytëzimin e pronës së paluajtshme nga paditësit, në të cilin shfrytëzim këta të fundit kanë bazuar kërkesën për vërtetim të së drejtës së tyre të pronësisë, Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vendosur gabimisht kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa ankesën e të paditurës e vlerëson si të qëndrueshme, në tërësi.

Në anën tjetër, edhe nëse paditësit do të provonin faktin se ngastrat kontestuese i kanë në posedim më shumë se 20 vite, kjo nuk do të provonte automatikisht faktin se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç e parasheh neni 28 parag.4 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP) që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik të pretenduar. Kjo për faktin se me nenin 29 të LMTHJP-së, parashihet se në pronë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMThJP-së të vitit 1996, neni në fjalë rezulton të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMThJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij (edhe nëse eventualisht do të zbatoheshin ndryshimet e ligjit të cekur më lartë, sërish nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, pasi që nga viti 1996 e deri në datën e parashkrimit të padisë 22.04.2010, nuk do të kalonte afati 20 vjeçar). Në këtë drejtim, nuk qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar se në rastin e

paditësve nuk mund të zbatohet neni 29 i LMTHJP-së, pasi që e paditura nuk është pronare e ngastrave kontestuese, por të njëjtat vetëm janë regjistruar në emër të paditurës, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit Sh. H., është vërtetuar fakti se këto ngastra janë blerë nga fondi ndërkombëtar për refugjat politik me seli në Gjenevë. Kështu që edhe në bazë të këtyre dispozitave që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rezulton se edhe nëse do të provohej fakti se e paditura është bërë pronare e ngastrave kontestuese pa ndonjë bazë të vlefshme juridike, paditësit nuk do të mund ta fitonin të drejtën e pronësisë mbi to, për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 10 vitesh për të parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë (pasi që është provuar fakti se e paditura është e evidentuar si pronare e këtyre ngastrave së paku që nga viti 1969, ndërsa padia nga paditësit është parashtruar në gjykatë në vitin 2010). Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditësve nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 28.4 i LMTHJP-së për të konstatuar se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrat kontestuese të cekura si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, të evidentuara si pronë shoqërore në emër të paditurës Komuna e Lipjanit.

Meqenëse nga të cekurat më lartë, ka rezultuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar në ligj dhe fakte, atëherë gjykata e shkallës së dytë u deshtë që të ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve

Në kësi rrethanash faktike, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit të paditësit se aktgjykimi i goditur është marrë me shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuar nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka dhënë arsye për faktet vendimtare të rëndësishme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike. Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi, si të drejt dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të të gjykatës së shkallës së dytë, nga se në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë janë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe e drejta materiale. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Pretendimet e revizionit që paditësi është në posedim të pa penguar të pronës së kërkuar dhe me këtë ka fituar pronësinë mbi bazën e parashkrimit fitues u refuzuan si të pabazuara. Lidhur me pretendimin revizionit se paditësi është një kohë të gjatë në posedim të pa penguar, Gjykata Supreme

miraton qëndrimin e gjykatave më të ulta dhe arsyetimin e dhënë në rastin konkret se çështja e posedimit nuk krijon raport pronësor e as të drejtë pronësie sepse në regjistrat kadastral figuron se prona është në pronësi të Komunës së Lipjanit. Në nenin 29 të LMTHPJ ka qenë e paraparë që "E drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, në pronësi shoqërore, nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit fitues". Me nenin 16 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fl.zyrt.e Jug.nr.29/96) është shlyer kjo dispozitë ligjore, pra neni 29 i këtij Ligji dhe është lejuar fitimi i pronësisë me mbajtje nën kushtet e caktuara me ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, dhe nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues. Padiësi ka deklaruar se patundshmërinë kontestuese e shfrytëzojnë prej vitit 1969, edhe pse është regjistruar si pasuri shoqërore, mirëpo deri në ndryshimin e ligjit LMTHPJ në vitin 1996 të drejtën e pronësisë nuk kanë mund ta fitojnë me parashkrim fitues, dhe një të drejtë të tillë nuk kanë mundur ta fitojnë as pas ndryshimeve të këtij Ligji në vitin 1996, për dy arsye, njëra është se, nga viti 1996 e deri në kohën e ushtrimit të padisë më 2010 nuk ka kaluar koha e paraparë për parashkrim fitues në patundshmëri sipas nenit 28 paragrafi 4 me kalimin e kohës prej 20 vjet, dhe arsyeja e dytë është se padiësi posedimin, edhe sikur të ishte më i gjatë, nuk e ka pasur me mirëbesim i cili në rastin konkret është fakt kyç për vendimmarrje të drejtë sipas kërkesëpadisë së padiësit. Në dispozitën e nenit 28 paragrafi 2 të Ligjit të lartë përmendur, për fitimin e pronësisë në patundshmëri parashihet plotësimi kumulativ i dy kushteve ligjore, që mbajtësi të jetë me mirëbesim dhe posedimi të jetë i ligjshëm, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni kërkohet që mbajtësi të jetë me mirëbesim, që do të thotë se në dy paragrafët kërkohet që gjithsesi mbajtësi të jetë me mirëbesim, që në rastin konkret me vet faktin se padiësi e ka ditur se prona është e regjistruar si shoqërore në pronësi të paditurës, rezulton se mbajtja e pronës nga padiësi nuk mund të konsiderohet se është me mirëbesim.

Gjykata Supremë gjene se është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi i Gjykatës së Apelit se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është "i ligjshëm" nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, nëse mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet.

Në lidhje me elementin e tretë që ka të bëjë me kalimin e periudhës kohore të caktuar me ligj, gjykata fillon numërimin prej ditës në të cilën zotëruesi ka fituar të drejtën e posedimit të objekti (sendit), ndërsa në këtë periudhë mund të përfshihet edhe koha kur pala paraardhëse ka mbajtur sendin si zotërues i ligjshëm dhe me pëlqim, ndërsa periudhën kohore që duhet të kalojë për fitimin e të drejtës së pronësisë e parasheh ligji (LMTHJP apo LPDS). Elementi i katërt ka të bëjë me posedimin e sendit mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, por mendon se sendi është i tij dhe nuk i përket dikujt tjetër. Si rrjedhojë, referuar provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë rezultojnë se në rastin e paditësve nuk përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura më lartë, për të konstatuar se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi ngastrat kontestuese

Lidhur me pretendimet e revizionit se në raste të ngjashme, kolegjet e Gjykatës së Apelit kanë vendosur ndryshe, Gjykata Supreme e pati në konsideratë dhe shqyrtoi rastet e ndryshme mbi të cilat pala e paditur në revizion potencon faktin se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike, të cilat gjykatat e instancës më të ulët, i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë të bazuara në vlerësimin e gabueshëm, të cilat sipas gjykatës së revizionit janë sqaruar në procedurën e shkallës së parë dhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës.

Nga sa u tha më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.165/2022 datë 06.07.2022

Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami